

1.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1.1 OBJEKTI

1.1.1 Kjo Rregullore përcakton tërësinë e rregullave mbi procedurat dhe kërkesat për të dhëna lidhur me publikimin në kohë të të gjitha të dhënave mbi konsumin, transmetimin, prodhimin e tregun balancues si të dhëna kyce të tregut, dhe njëkohësisht disponibilitetin e tyre për të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë, si një parakusht për funksionimin e tregut të energjise elektrike në mënyre transparente dhe jo diskriminuese.

1.1.2 Kjo Rregullore gjithashtu përcakton detyrimet e operatorit të sistemit të transmetimit, operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe operatorit të sistemit të mbyllur të shpërndarjes, prodhuesve të energjisë elektrike dhe klientëve fundorë, në lidhje me publikimin e të dhënave të tregut dhe ceshtjeve të tjera të nevojshme në publikimin e tyre.

1.2 DORËZIMI DHE PUBLIKIMI I TË DHËNAVE

1.2.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të publikojë në kohë të gjithë të dhënat përkatëse në lidhje me ngarkesën totale të parashikuar si dhe ngarkesën faktike, disponueshmërinë dhe përdorimin e kapacitetit rezervë të transmetimit dhe kapacitetit të interkoneksioneve, parashikimi i gjenerimit dhe gjenerimi faktik dhe të dhënat për balancimin e tregut të energjise elektrike të percaktuara në keto rregulla (ketej e tutje do të quhen Të Dhënat Bazë të Tregut) në përputhje me ligjin i cili rregullon sektorin e energjise elektrike (ketej e tutje do të quhet thjeshtë Ligji).

1.2.2 Operatori i Sistemit të Transmetimit do të sigurojë publikimin e të Dhënave bazë të Tregut brenda afateve dhe përmbajtjes të percaktuar në këto Rregulla në një mënyre që ti bëjë ato të disponueshme në faqen e internetit të OST sh.a (www.ost.al) dhe shkëmbimin e të dhënave elektronike në Rrjetin European të Operatoreve të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike (www.entsoe.eu) për të gjithë pjesëmarrësit e tregut.

1.2.3 Për të Publikuar të Dhenat Bazë të Tregut në përputhje me këto Rregulla, Operatori i Sistemit të Transmetimit përdor të gjithë informacionin e vënë në dispozicion nga prodhuesit e energjisë elektrike, si edhe të dhënat nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe të dhënat e klientëve fundorë, nëse keto të dhëna janë dorëzuar tek Operatori i sistemit të transmetimit brenda afatit dhe sipas përmbajtjes të percaktuar në keto rregulla.

1.2.4 Për të Publikuar të Dhënat Bazë të Tregut në përputhje me keto Rregulla, prodhuesit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Operatori i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes dhe klientët fundorë, duhet të dorëzojnë të dhënat e përshkruara në këto Rregulla sipas formatit të percaktuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

1.2.5 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të dorëzojë tek Operatori i Sistemit të Transmetimit, informacionin e mëposhtem:

- Kapacitetin e instaluar gjenerues të të gjithë njësive gjeneruese të lidhura në rrjetin e shpërndarjes, ose sistemin e mbyllur të shpërndarjes;
- Gjenerimin total faktik në sistemin e shpërndarjes, apo në sistemin e mbyllur të shpërndarjes për intervalin llogaritës;
- Gjenerimin faktik nga të gjitha tipet gjeneruese lidhur në sistemin e shpërndarjes apo në sistemin e mbyllur të shpërndarjes për periudhën llogaritëse;
- Gjenerimi faktik nga centralet fotovoltaike dhe nga centralet e erës në sistemin e shpërndarjes apo në sistemin e mbyllur të shpërndarjes;
- Parashikimin e gjenerimit total të ditës në avancë në sistemin e shpërndarjes dhe sistemin e mbyllur të shpërndarjes;
- Parashikimin e ditës në avancë të gjenerimit nga centralet fotovoltaike dhe nga centralet e erës në sistemin e shpërndarjes apo në sistemin e mbyllur të shpërndarjes;

1.2.6 Prodhuesit e energjisë duhet të dorëzojnë tek Operatori i Sistemit të Transmetimit informacionin e mëposhtem:

- Kapaciteti i instaluar total i gjeneruesve të lidhur në sistemin e transmetimit;
- Kapaciteti i instaluar e çdo njesie gjeneruese të lidhur në Sistemin e Transmetimit (të klienteve në treg të liberalizuar);
- Gjenerimi faktik i njësive prodhuese;
- Gjenerimi faktik nga centralet fotovoltaike dhe nga centralet e erës;
- Gjenerimin faktik të prodhuesve të lidhur në sistemin e transmetimit për intervalin llogaritës,
- Parashikimin e gjenerimit total të ditës në avancë të gjeneruesve në sistemin e transmetimit;
- Parashikimin e ditës në avancë të gjenerimit nga centralet fotovoltaike dhe nga centralet e erës në sistemin e transmetimit;
- Mosdispunueshmeria faktike e njësive gjeneruese;
- Mosdispunueshmeria faktike e njësive prodhuese;
- Planifikimi i mosdispunueshmerisë së njësive gjeneruese;
- Planifikimi i mosdispunueshmerisë së njësive prodhuese;

1.2.7 Klientet në treg të liberalizuar duhet të dorëzojnë në operatorin e sistemit të transmetimit informacionin në vijim:

- Padsipunueshmerinë e planifikuar të njësive të konsumit;
- Pa disipunueshmerinë faktike të njësive të konsumit.

1.2.8 Operatori i Sistemit te Transmetimit duhet te siguroje informacionin ne vijim:

- Vlera e shkëmbimit ndërkufitar të energjisë elektrike;
- Parashikimi i ngarkeses per ditën/javën/muajin/vitin ne avance;
- Marzhi i parashikimit per vitin ne avance;
- Plani i Zhvillimit;
- Nderprerjet e planifikuara ne sistemin e transmetimit;
- Ndryshimet ne disponueshmerine e interkonjeksioneve dhe rrjetit te transmetimit;
- Kapaciteti i parashikuar ndër-kufitar;
- Kapaciteti i ofruar ndër-kufitar;
- Raport vjetor rreth elementeve kritik te rrjetit qe kufizojne kapacitetet e ofruara;
- Perdorimi i kapaciteteve te transmetimit–ankandet;
- Perdorimi i kapaciteteve te transmetimit alokimet;
- Kapaciteti total i nominuar;
- Kapaciteti total i alokuar;
- Cmimet ne ditën ne avance ne tregun e organizuar te energjise elektrike;
- Totali i shkembimeve tregatave te skeduluara;
- Fluksi fizik;
- Menaxhimi kongjestionit - ridispecerimi
- Menaxhimi i kongjestionit ;
- Raport i menaxhimit te kongjestionit;
- Rregullat e balancimit;
- Sasia e reserves balancuese sipas kontrates;
- Cmimet e kapacitetit rezerve te rezervave balancuese
- Sasia e ofertave te pranuar
- Sasia e rezervave te balancimit te aktivizuara
- Cmimi i rezervave te balancimit te aktivizuara;
- Cmimet e disbalancave;
- Sasia totale e disbalancave;
- Balanca mujore financiare;
- Sasia totale e ofertave per aktivizimin e balancimit nderrajonal;
- Cmimet nderzonale te kerkese ofertave per disbalancat;
- Sasia e energjise se aktivizuar ne zonat nderajonale per balancimin;

1.2.9 Te dhenat duhet te dorezohen me e-mail ose me ane te sistemit te informacionit. Shperndarja e informacionit konsiderohet efektive kur derguesi merr nga marresi konfirmimin per marrjen e informacionit me ane te e-malit apo sistemit te informacionit. Marresi dhe derguesi duhet te koordinojne sistemet e informacionit per te siguruar konfirmimin elektronik te marrjes se informacionit .

1.2.10 Shperndarja e njoftimeve duhet te behet direkt me korrier, e-mail faks. Shperndarja behet efektive ne ditën e marrjes se konfirmimit me shkrim nga marresi te informacionit , ose te një konfirmimi me e-mail per marrjen e njoftimit,

1.2.11 Subjektet e referuara në seksionin 1.2.3 me siper jane pergjegjes per kohëzgjatjen, plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të dorëzuara tek Operatori i Sistemit të Transmetimit.

1.2.12 Subjektet e referuara në paragrafin 1 të këtij neni do të njoftojne operatorin e sistemit të transmetimit për ndryshimet në emrin, adresën e biznesit, numrin e telefonit, faksin, postën elektronike, ndryshimin e personit të autorizuar për dorëzimin e të dhënave dhe ndryshimeve të tjera që ndikojnë në publikimin e të dhënave.

1.2.13 Konfidencialiteti i te dhenave

1) Prodhuesi i energjisë elektrike duhet te siguroje konfidencialitetin e te dhenave ne përputhje me sa parashikuar ne Ligjin per Sektorin e Energjise Elektrike.

2) Operatori i sistemit të transmetimit publikon te dhenat korresponduese per piken e interkonjeksionit dhe periudhen perkatese sipas pikave 4.2.1, 4.3.1, 4.14.1 te ketyre rregullave.

2. PERKUFIZIME DHE SHKURTIME

2.1 PERKUFIZIME <i>Termt e përdorur ne kete Rregullore kane kuptimin e meposhtëm:</i>	
Rezerva balancuese te kontraktuara	nenkupton kapacitetet e disponueshme te njesive te balancimit te percaktuara ne perputhje me Rregullat e operimit te sistemit te transmetimit dhe rregullat e operimit te tregut te energjise elektrike
Tregtimi nderkufitar	shkembimi i energjise nderkufitar per te shmangur kongestionet
Gjenerimi neto	prodhimi neto faktik ne njesite e lidhura ne transmetim dhe ne shperndarje brenda nje zone kontrolli ne nje interval llogarites.
Intervali llogarites	nenkupton periudhen gjate se cilës bëhet llogaritja , periudhë kjo e percaktuar në përputhje me rregullat e operimit te sistemit te transmetimit dhe rregullat e operimit te tregut te energjise elektrike .
Njesi konsumi	nenkupton njësinë e klientit final te energjisë elektrike
Njesi gjeneruese	nenkupton një gjenerator i vetëm brenda njësisë të prodhimit të prodhuesit të energjisë elektrike.
Njësi prodhuese	nenkupton nje objekt per gjenerimin e energjisë elektrike me një apo më shumë gjeneratorë
Javë	intervali kohor nga e Hëna ne orën 00:00 deri te Dielën ne 24:00 .
Tipi i gjenerimit	gjenerimi i percaktuar në varësi te burimit të përdorur për prodhimin e energjisë elektrike, percaktuar sipas termave te kësaj Rregulloreje: fosilet - (qymyr kaf / lignite, qymyr i zi, gaz qymyri, nafta, nenproduktet e naftes, gazit natyror,); hidro - (me dige dhe derivacion); i rinovueshem - (erë , energji diellore , energjia gjeotermike , biomasa dhe burime te tjera te rinovueshme sipas ligjit per energjite e rinovueshme 7/2017)
<i>Termt e tjera te perdorur ne kete rregullore kane kuptimin sipas Ligjit dhe Rregulloreve te miratuara me ligj qe rregullojne operimin e sistemit te transmetimit, operimin e tregut dhe shperndarjen e kapacitetit nderkufitar te sistemit te transmetimit.</i>	

2.2 SHKURTIME <i>Shkurtimet e perdorura ne kete rregullore kane kuptimet e meposhtme :</i>	
ATC	(Kapaciteti Transmetues i Disponueshem) – nenkupton diferencen ndermjet kapacitetit neto te transmetimit dhe kapacitetit tashme te alokuar;
EIC	(Kodi i Identifikimit te Energjise) – nenkupton kodin identifikues te perdorur per njesite dhe elementet ne sistemin e energjise elektrike; lista e kodeve jepet ne websit-in e Operatoreve te Rrjetit Evropian te Transmetimit te Energjise Elektrike (ENTSO-E) https://www.entsoe.eu/fileadmin/user_upload/edi/library/eic/cds/area.htm
NTC	(Kapaciteti Neto i Transmetimit) eshte programi maksimal i shkembimit ndermjet dy zonave te kontrollit fqinje duke konsideruar standartet e sigurise te zbatueshme ne te gjitha zonat e kontrollit te zones sinkrone, si dhe duke konsideruar gjithashtu pasigurine teknike qe lidhet me parashikimin e kushteve te punes se rrjetit
UIOSI	(perdore-ose shite) – eshte nje rregull sipas se cilit kapaciteti nderkufitar I transmetimit jo i nominuar , behet automatikisht disponibel per alokimin e kapacitetit per ditën ne avance.

3. TE DHENAT BAZE TE TREGUT MBI KONSUMIN

3.1. NGARKESA TOTALE FAKTIKE

3.1.1 Operatori i Sistemit te Transmetimit publikon vleren mesatare te ngarkeses se pergjithshme aktuale brenda nje intervali kohor sipas formules ne vijim :

Ngarkesa aktuale = gjenerimi neto - Export + Import ku:

Gjenerimi neto- perfaqeson gjenerimin e pergjithshem actual ne transmetim dhe shperndarje ne zonen e kontrollit ne nje periudhe llogaritese.

Eksport i deklaruar eshte dispecerimi I energjise elektrike qe I korespondon sasise se energjise elektrike qe levrohet njekohesisht ne nje vend tjeter si import I deklaruar mbi bazen e nje marredhenie kontraktuale.

Import i deklaruar eshte energjia elektrike qe levrohet ne nje vend e cila ne te njejten kohe dispecerohet si eksport i deklaruar nga nje vend tjeter.

Ne rast se prodhuesi i energjise elektrike nuk eshte ne gjendje te injektoje nje mase te caktuar te energjise elektrike ne transmetimit, atehere ai mund ta injektoje ate, tek njesite e balancimit .

3.1.2 Prodhuessit e energjise elektrike duhet te dorezojne prane operatorit te sistemit te transmetimit te dhena lidhur me gjenerimin total te njesive lidhur ne transmetim per nje interval te caktuar llogarites

3.1.3 Operatori i sistemit te shperndarjes ose operatori i sistemit te mbyllur te shperndarjes duhet te dorezojne tek operatori i sistemit te transmetimit te dhena mbi gjenerimin faktik te pergjithshem te njesive te lidhura ne rrjetin e shperndarjes ose ne sistemin e mbyllur te shperndarjes 50 minuta pas cdo interval llogarites.

3.1.4 Informacioni duhet te publikohet jo me vone se nje ore (H+1) pas cdo interavali llogarites .

3.1.5 Ne rast korrigjimi, duhet te behet ridorezimi i te dhenave te korrigjuara.

3.2. PARASHIKIMI I NGARKESES TOTALE TE DITES NE AVANCE

3.2.1. Operatori i Sistemit te Transmetimit duhet te publikoje te dhenat mbi vlerat mesatare te ngarkeses totale per ditën ne avance jo me vone se dy ore para skadimit te afatit per dorezimin e ofertave ne tregun e organzuar te energjise elektrike.

3.3 PARASHIKIMI I NGARKESES TOTALE TE JAVES NE AVANCE

3.3.1 Operatori i sistemit te transmetimit duhet te publikoje vleren mesatare te maksimumit dhe minimumit te ngarkeses se parashikuar per intervalin llogarites per cdo dite te javes ne vijim.

3.3.2 Informacioni duhet te publikohet te premtën ne oren 14:00 ne javen pararendese te javes se ciles i perkasin te dhenat

3.4 PARASHIKIMI I NGARKESES TOTALE TE MUAJIT NE AVANCE

3.4.1 Operatori i sistemit te transmetimit duhet te publikoje vleren mesatare te maksimumit dhe minimumit te ngarkeses se parashikuar per intervalin llogarites per cdo jave te muajit ne vijim

3.4.2 Informacioni duhet te publikohet ne javen qe i paraprin dites se pare te muajit te cilit i perkasin te dhenat pararendese te javes se ciles i perkasin te dhenat (M-1).

3.5. PARASHIKIMI I NGARKESES TOTALE TE VITIT NE AVANCE

3.5.1 Operatori i sistemit te transmetimit duhet te publikoje vleren mesatare te maksimumit dhe minimumit te ngarkeses se parashikuar per intervalin llogarites per cdo jave te vitit ne vijim

3.5.2 Informacioni duhet te publikohet jo me vone se 15 dite para fillimit te vitit kalendarik te cilit i perkasin te dhenat.

3.6. MOSDISPONIBILITETI I PLANIFIKUAR I NJESIVE TE KONSUMIT

3.6.1 Operatori i sistemit te transmetimit duhet te publikoje te dhenat e pergjithshme mbi kohezgjatjen e mosdisponibilitetit te planifikuar te te gjitha njesive te konsumit me te medha ose te barabarta me 100 MW per nje interval te caktuar llogarites.

3.6.2 Klientet ne tregun e liberalizuar duhet te dorezojne tek operatori i sistemit te transmetimit informacionin e meposhtem mbi njesite e konsumit me konsum me te larte ose te barabarte me 100 MW:

- EIC te njesise se konsumit ;
- Vleren e energjise se padisponueshme ;
- Arsyen e mosdiponibilitetit ;
- Fillimin dhe mbarimin e mosdisponibilitetit (dite, muaj, vit, ore, minute);
- ndonje informacion apo koment shtese nese ka

3.6.3 Klientet ne tregun e liberalizuar duhet te dorezojne tek operatori i sistemit te transmetimit informacionin sipas seksionit 3.6.2 jo me vone se 50 minuta pas planifikimit te mosdisponibilitetit te njesise gjeneruese

3.6.4 Ne rast te korrigjimit te te dhenave te dorezuara, klientet ne tregun e liberalizuar duhet te dorezojne te dhenat e korrigjuara jo me vone se nje ore (H+1) pas korrigjimit nga ana e tij.

3.6.5 Informacioni duhet te publikohet jo me vone se nje ore pas marrjes se vendimit per mosdiponibilitetin e njesise se konsumit.

3.7. MOSDISPONIBILITETI FAKTIK I NJESIVE TE KONSUMIT

3.7.1 Operatori i Sistemit te Transmetimit duhet te publikoje te dhenat e mosdisponibilitetit per te gjithë njesite e konsumit me fuqi te aprovuar me te madhe ose te barabarte me 100 MW dhe kohezgjate minimale nje interval llogarites.

3.7.2 Klientet ne tregun e liberalizuar duhet te dorezojne tek Operatori i sistemit te transmetimit informacionin e meposhtem mbi njesite e konsumit me kapacitet me te madh ose te barabarte me 100 MW:

- EIC te ngarkeses se njesise ;
- Vlera e energjise se disponueshme ;
- Arsyet e mosdisponibilitetit ;
- Fillimi dhe koha qe mendohet te ndryshoje (dite, muaj, vit, ore, minute);
- Ndonje informacion apo koment shtese nese ka.

3.7.3 Klientet ne tregun e liberalizuar duhet te dorezojne tek operatori i sistemit te transmetimit informacionin nga seksioni 3.7.2 jo me vone se 50 minuta pas ndryshimit te mosdiponueshmerise se njesive te konsumit

3.7.4 Informacioni duhet te publikohet jo me vone se nje ore (H+1) pas ndryshimit te mosdisponibilitetit te njesive te konsumit

3.7.5 Ne rast te korrigjimit te te dhenave te dorezuara, klienti ne tregun e liberalizuar duhet te dorezoje te dhenat e korrigjuara jo me vone se nje ore (H+1) pasi eshte bindur per te ndryshuar te dhenat.

3.8 PARASHIKIMI I MARZHIT NJE VIT AVANCE

3.8.1 Operatori i Sistemit te Transmetimit publikon parashikimin e marxhit te nje viti ne avance.

3.8.2 Marzhi i parashikuar i nje viti ne avance percaktohet si diference ndermjet gjenerimit neto vjetor te parashikuar dhe ngarkeses vjetore te parashikuar, duke marre ne konsiderate kapacitetin total te parashikuar, disponibilitetin e njesise gjeneruese dhe sherbimet ndihmese.

3.8.3 Ne llogaritjen e marzhit te parashikuar te nje viti ne avance, Operatori i Sistemit te Transmetimit perdor te dhenat mbi vlerat e parashikuara te gjenerimit dhe ngarkeses ne intervalin llogarites me vleren me te larte te ngarkeses se parashikuar per vitin ne vijim.

3.8.4 Informacioni publikohet jo me vone se nje jave perpara javes ne te cilen behet ankandivjetor,ose 15 dite para fillimit te vitit dhe te cilin lidhen te dhenat.

4. TË DHËNAT BAZË TË TREGUT PËR TRANSMETIMIN

4.1. RAPORTIMI MBI ZHVILLIMET

4.1.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë një listë të projekteve për ndërtimin, çmontimin dhe rikonstruksionin e elementeve të sistemit të transmetimit, efektet e të cilave në NTC kalojnë 100MW, dhe që operatori i sistemit të transmetimit do të zbatojë brenda tre viteve të ardhshme në përputhje me planin dhjetë-vjeçar të Zhvillimit dhe Planit të Investimeve në sistemin e Transmetimit.

4.1.2. Informacioni duhet të publikohet një javë para datës së zhvillimit të ankandit vjetor ose 15 ditë para fillimit të vitit që i referohen të dhënat.

4.2. PADISPONUESHMERIA E PLANIFIKUAR NË RRJETIN E TRANSMETIMIT

4.2.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë padisponueshmëritë e planifikuara në rrjetin e transmetimit për zonën e kontrollit dhe që shkaktojnë reduktimin e NTC mbi 100 MW dhe kohëzgjatje minimale një interval llogaritje.

Do të publikohet informacioni i mëposhtëm:

- EIC i linjës së energjisë;
- Vendndodhja - shënimi i kufirit;
- Emri i aktivitetit;
- Lloji i aktivitetit;
- Efektet e vlerësuar në NTC;
- Arsyeja e padisponueshmërisë;
- Data e fillimit dhe e fundit të padisponueshmërisë (ditë, orë);
- Komente ose informacione shtesë, nëse ka.

4.2.2. Informacioni do të publikohet një orë (H + 1) pas vendimit për padisponueshmërinë e planifikuara.

4.3. NDRYSHIMET NË DISPONUESHMËRINE FAKTIKE TË INTERKONEKSIONEVE DHE RRJETIN E TRANSMETIMIT

4.3.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë ndryshimet në disponueshmërinë faktike të Interkoneksioneve dhe rrjetit të transmetimit në zonën e kontrollit ku shkaktohet reduktim i NTC mbi 100 MW dhe kohëzgjatje minimale një interval llogaritje.

Do të publikohet informacioni i mëposhtëm:

- EIC e elementeve të sistemit të energjisë elektrike;
- Vendndodhja - shënimi i kufirit;
- Emri i aktivitetit;
- Lloji i aktivitetit;
- Efektet e vlerësuar në NTC;
- Arsyeja e padisponueshmërisë;
- Data e fillimit dhe (parashikimi) e fundit të padisponueshmërisë (ditë, orë);
- Komente ose informacione shtesë, nëse ka.

4.3.2. Informacioni duhet të publikohet një orë (H + 1) pas ndryshimit të disponueshmërisë.

4.4. PARASHIKIMI I KAPACITETIT NDER-ZONAL

4.4.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë NTC vjetore, mujore dhe ditore:

- a) Për NTC vjetore - vlera për secilin muaj (një vlerë minimale të cdo muaji);
- b) Për NTC mujore - vlera për çdo ditë të muajit (një vlerë minimale për cdo ditë);
- c) Për NTC ditore - vlera për çdo interval llogaritje të ditës.

4.4.2. Informacioni duhet të publikohet:

- Për NTC vjetore, për vitin Y, shtatë ditë para ditës për dorëzimin e kërkesës për ankandet vjetore, por jo më vonë se 15 dhjetori i vitit Y-1;
- Për NTC mujore jo më vonë se dy ditë pune para ditës për dorëzimin e një kërkesë për ankandet mujore;
- Për NTC ditore, jo më vonë se një orë para skadimit të afatit për dorëzimin e ofertes për pjesëmarrje në një treg te organizuar “day-ahead”.

4.5. KAPACITETET E OFRUARA TE TRANSMETIMIT CROSS-BORDER

4.5.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë ATC vjetore, mujore, ditore dhe brenda ditës për çdo kufi dhe drejtim, si më poshtë:

- Për ATC vjetore - vlera për secilin muaj (një vlerë minimale për cdo muaj);
- Për ATC mujore - vlera për çdo ditë të muajit (një vlerë minimale për cdo ditë);
- Për ATC ditore - vlera për secilin interval llogaritje të ditës;
- Për ATC brenda dites - vlera për secilin interval llogaritje të ditës;

4.5.2. Informacioni duhet të publikohet:

- Për ATC vjetore, për vitin Y, shtatë ditë para ditës për dorëzimin e kërkesës për ankand vjetor, por jo më vonë se 15 dhjetori i vitit Y-1;
- Për ATC mujore jo më vonë se dy ditë pune para ditës për dorëzimin e kërkesës për ankandet mujore;
- Për ATC ditore, jo më vonë se një orë para skadimit të afatit për dorëzimin e ofertes për pjesëmarrje në një treg të organizuar “day ahead”;
- Për ATC brenda ditës, një orë para se ndarjes së parë brenda ditës dhe pas çdo ndryshimi.

4.6. RAPORTIMI VJETOR RRETH ELEMENTEVE KRITIKE TË RRJETIT QË LIMITOJNE KAPACITETET E OFRUARA.

4.6.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë të dhënat mbi elementet kritike të rrjetit të cilat kufizojnë përdorimin e kapacitetit të ofruar.

4.6.2. Informacioni duhet të publikohet nga fundi i muajit Shkurt të vitit.

4.7. PËRDORIMI I KAPACITETEVE TË TRANSFERUARA - ANKANDET

4.7.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë të dhënat për ankandet eksplicite vjetore, mujore dhe ditore për çdo kufi dhe drejtim, si më poshtë:

- Kapaciteti transmetues ndër-kufitar i kerkuar (MW);
- Kapaciteti transmetues ndër-kufitar i Alokuar (MW);
- Çmimet marginale (në EUR / MW)
- Të ardhurat nga Ankandet (në EUR).

4.7.2. Informacioni do të publikohet një orë (h + 1) pas ankandeve të përfunduara.

4.9. KAPACITETI TOTAL I NOMINUAR

4.9.1. Operatori i sistemit të transmetimit publikon kapacitetin total të nominuar për çdo Interval llogaritje në një ditë.

4.9.2. Kapaciteti total i transmetimit ndërkufitar i nominuar është një kapacitet total per cdo kufi dhe drejtim, nominuar nga pjesëmarrësit e tregut që raportojne plane ditore të punës (vjetore, mujore, javore, ditore dhe brenda ditës), dhe dakortësuar e konfirmuar nga Operatori i sistemit të transmetimit fqinje.

4.9.3. Informacioni duhet të publikohet një orë pas çdo procesi bashkërendimi dhe konfirmimi (H + 1).

4.10. KAPACITETI TOTAL I ALOKUAR

4.10.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë për çdo kufi dhe drejtim:

- Kapaciteti mujor të alokuar;
- Kapaciteti Ditor të alokuar.

4.10.2. Kapaciteti mujor i alokuar përfaqëson transmetimit Kapacitetin ndërkufitar të alokuar në ankandet vjetore të reduktuara nga vlera e kapacitetit të kthyer për çdo ditë të muajit.

4.10.3. Kapaciteti ditor i alokuar paraqet kapacitetin total të transmetimit ndërkufitar alokuar në ankandet vjetore dhe mujore, I reduktuar me vlerën e kapacitetit të kthyer vjetor dhe me vlerën e kthyer të kapacitetit duke zbatuar parimin e UIOSI (përdore ose shite) për secilin interval llogaritës për ditën në të cilën të dhënat i referohen.

4.10.4. Informacioni duhet të publikohet:

- për kapacitet mujor të alokuar, dy ditë pune para zhvillimit të ankandëve mujore;
- për kapacitet ditor të alokuar, një orë para përfundimit të procesit të dorëzimit e ofertave në një ditë më përpara për tregun e organizuar të energjisë elektrike;

4.11. ÇMIMET E DITËS NË AVANCË

4.11.1. Operatori i sistemit të transmetimit publikon çmimet (EUR / MWh) të dites ne avance në tregun e organizuar të energjisë elektrike të zonës së tregut për çdo interval të llogaritjes

4.11.2. Informacioni duhet të publikohet jo më vonë se një orë (H + 1) para skadimit të të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave në një ditë më përpara në tregun e organizuar të energjisë elektrike.

4.12. TOTALI I SKEDULUAR I I SHKËMBIMEVE TREGTARE

4.12.1. Operatori i sistemit të transmetimit publikon shkëmbimeve tregtare totale të skeduluara për secilin intervali llogaritje në një ditë.

4.12.2. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të përcaktojë shkëmbimet tregtare të skeduluara si një kapacitet total për kufi dhe drejtëm, emëruar nga pjesëmarrësit e tregut që kanë të drejtën për të raportuar planet e përditshme të punës (vjetore, mujore, javore, ditore dhe brenda ditës), transaksionet, kanë rënë dakort për të konfirmuar ndërmjet operatorëve të sistemit të transmetimit fqinje

4.12.3. Informacioni do të publikohet jo më vonë se një orë (H + 1) pas mbylljes së procesit të nominimit të ditës në avance, dhe ri-dorëzimi do të bëhet jo më vonë se dy orë (H + 2) pas secilit proces nominimi brenda ditës.

4.13. FLUKSET FIZIKE

4.13.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë vlerat mesatare të flukseve të fuqisë (MW) në mes të zonave të tregut për çdo interval të llogaritjes në një ditë.

4.13.2. Informacioni duhet të publikohet jo më vonë se një orë (H + 1) pas çdo intervali llogarie.

4.14. – MENAXHIMI KONGJESTIONIT -RIDISPEÇERIMI

4.14.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë informacionin lidhur me ridispeçerimin për intervalin e llogarive:

- Veprimet e ndermara (rritje ose ulje në prodhimin, rritje apo ulje në konsum);
- EIC të elementit;
- Vendodhjen - shënimi i kufirit;
- Emri i asetit;
- Lloji i asetit;
- Arsyeja për ridispeçerimin;
- efektet e parashikuara në kapacitetin e transmetimit (MW);
- Fillimi dhe datën fundit të ridispeçerimit (ditë, orë);
- Komente ose informacion shtesë, nëse ka ndonjë.

4.14.2. Informacioni duhet të publikohet një orë pas intervalit të llogaritjeve (H + 1) në të cilën filloi ridispeçerimi.

4.15. MENAXHIMI I KONESTIONIT - TREGETIMI NDËRKUFITAR (COUNTERTRADING)

4.15.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë të dhënat lidhur me tregetimit ndërkufitar për interval llogaritje.

Informacioni i mëposhtëm do të publikohet:

- Veprimi marra (rritje ose ulje në shkëmbimin e energjisë elektrike ndërkufitar);
- Kufirir / drejtim;
- Arsyeja;
- e parashikuar efektet në kapacitetin ofrohet (MW);
- Fillimi dhe data e fundit (ditë, orë);
- Koment ose informacion shtesë, nëse ka ndonjë.

4.15.2. Informacioni duhet të publikohet një orë pas intervalit të llogaritjes (H + 1) në të cilën fillon tregetimi ndërkufitar.

4.16. RAPORT I MENAXHIMIT TË KONGJESTIONIT

4.16.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë informacion në lidhje me kostot mujore të menaxhimit të kongjestionit, sidomos për ridespeçerim të tregetimit ndërkufitar dhe kostos totale.

4.16.2. Informacioni duhet të publikohet jo më vonë se dita e fundit e punës të muajit (M + 1) pas muajit (M), në të cilën janë marrë veprimet e menaxhimit të kongjestionit.

5. TË DHËNAT THEMELORE TË TREGUT MBI GJENERIMIN

5.1. FUQIA E PËRGJITHSHME GJENERUESE E INSTALUAR

5.1.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë kapacitetin gjenerues të instaluar për të gjitha njësitë prodhuese (në MW) të kapaciteteve të instaluara më të mëdha ose të barabarta me 1 MW sipas tipit të gjeneruesit.

5.1.2. Prodhuesit e energjisë elektrike do të paraqesin pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të dhëna të kapacitetit gjenerues të instaluar nga njësitë prodhuese në rrjetin e transmetimit, të përmbledhura sipas tipit të gjeneruesit, jo më vonë se dy javë përpara fillimit të vitit të cilit I përkasin këto të dhëna.

5.1.3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose Operatori i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes do të paraqesi të dhënat pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit mbi kapacitetin gjenerues të instaluar nga njësitë prodhuese në rrjetin e shpërndarjes, të mbledhura sipas tipit të gjeneruesit, jo më vonë se dy javë përpara fillimit të vitit të cilit I përkasin këto të dhëna.

5.1.4. Të dhënat e mbledhura sipas tipit të prodhimit do të publikohen jo më vonë se një javë përpara fillimit të vitit të cilit I përkasin këto të dhëna.

5.1.5. Riparaçitja e të dhënave do të jetë e mundur në rast se duhet të korigjohen vlera të cilat janë paraqitur më përpara.

5.2. KAPACITETIT I INSTALUAR SIPAS NJËSIVE PRODHUESE

5.2.1. Operatori i sistemit do të publikojë të dhënat mbi njësitë prodhuese (ekzistuese dhe të planifikuara, në MW) të kapaciteteve të instaluar më të mëdha ose të barabarta me 100 MW (emrin e njësisë prodhuese, EIC, kapacitetit të instaluar (MW) në fillim të vitit, kapaciteti i instaluar aktual (MW), tipi I gjeneruesit).

5.2.2. Të dhënat në pikën 5.2.1. do të publikohen për periudhën që mbulon tre vitet e ardhshme.

5.2.3. Prodhuesit e energjisë elektrike do të paraqesin pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit:

- Emrin e njësisë prodhuese;
- Kapacitetin e instaluar (MW);
- Vendndodhjen;
- Nivelin e tensionit në pikën e lidhjes;
- Tipin e gjeneruesit;

5.2.4. Prodhuesit e energjisë elektrike do të paraqesin të dhënat e pikës 5.2.3. pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit jo më vonë se dy javë përpara fillimit të vitit të cilit i përkasin këto të dhëna.

5.2.5. Të dhënat e pikës 5.2.1. do të publikohen një javë përpara fillimit të vitit të cilit i përkasin këto të dhëna.

5.2.6. Riparaçitja e të dhënave do të jetë e mundur në rast se duhet të korigjohen vlera të cilat janë paraqitur më përpara.

5.3. GJENERIMI I MBLEDHUR I NJË DITE MË PËRPARA

5.3.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë një vlerësim të gjenerimit të mbledhur të një dite më përpara (në MW) të zonës së kontrolluar për secilin interval të llogaritur.

5.3.2. Prodhuesit e energjisë elektrike do të paraqesin të dhënat pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të gjenerimit të mbledhur në sistemin e transmetimit për çdo interval të llogaritur, jo më vonë se dita që paraprin ditën për të cilën lidhen të dhënat (D-1), deri në orën 17:30.

5.3.4. Në bazë të të dhënave të paraqitura në pikën 5.3.2., operatori I sistemit do të publikojë të dhënat nga pika 5.3.1. në ditën që paraprin ditën për të cilën lidhen të dhënat (D-1), deri në orën 18:00.

5.3.5. Riparimitja e të dhënave do të jetë e mundur në rast se duhet të korigjohen vlera të cilat janë paraqitur më përpara.

5.4. PARASHIKIMI NJË DITË NË AVANCË I GJENERIMIT PËR EOLIKËT DHE FOTOVOLTAIKËT

5.4.1. Operatori I Sistemit të Transmetimit do të publikojë një parashikim të gjenerimit të një dite më përpara në total (vlera neto) për energjinë diellore dhe një parashikim të gjenerimit të një dite më përpara në total (vlera neto) për energjinë nga era (MW) për cdo interval të llogaritur.

5.4.2. Prodhuesit e energjisë së gjeneruar nga dielli dhe era do të paraqesin këto të dhëna:

- vlera mesatare e parashikuar e energjisë së gjeneruar nga dielli për sejcilin interval të llogaritur për cdo ditë;
- vlera mesatare e parashikuar e energjisë së gjeneruar nga era për sejcilin interval të llogaritur për cdo ditë;

5.4.3. Prodhuesit e energjisë elektrike do të paraqesin të dhënat e gjenerimit pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të mbledhura në sistemin e transmetimit për cdo tip të energjisë elektrike të pikës 5.4.2., jo më vonë se dita që paraprin ditën për të cilën lidhen të dhënat (D-1), deri në orën 17:30.

5.4.4. Operatori I Sistemit të Shpërndarjes ose Operatori I Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes do të paraqesin të dhënat të përmbledhura Operatorit të Sistemit të Transmetimit për cdo tip të energjisë elektrike të pikës 5.4.2. në sistemin e shpërndarjes ose sistemin e mbyllur të shpërndarjes, jo më vonë se dita që paraprin ditën për të cilën lidhen të dhënat (D-1), deri në orën 17:30.

5.4.5. Në bazë të të dhënave të paraqitura në pikën 5.4.2, të dhënat e mbledhura sipas pikës 5.4.1. do të publikohen ditën që paraprin ditën për të cilën lidhen të dhënat (D-1), deri në orën 18:00.

5.4.6. Në rastin e ndryshimit të të dhënave të paraqitura, prodhuesi dhe Operatori I Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatori i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes do të paraqesin të dhënat deri në orën 8:00 në ditën për të cilën lidhen të dhënat.

5.5 PADISPONUESHMËRIA E PLANIFIKUAR E NJËSIVE GJENERUESE

5.5.1 Operatori I Sistemit të Transmetimit do të publikojë të dhënat në lidhje me padisponueshmërinë e planifikuar të njësive gjeneruese në rast se padisponueshmëria e planifikuar është më e madhe ose e barabartë me 100 MW dhe me një kohëzgjatje jo më pak se një interval i llogaritur.

5.5.2 Prodhuesit do të paraqesin të dhëna pranë Operatorin të Sistemit të Transmetimit:

- Emrin e njësisë prodhuese;
- Emrin e njësisë gjeneruese;
- Vendndodhjen;
- Kapacitetin e instaluar (MW);
- Tipin e gjeneruesit;
- Kapaciteti në dispozicion (vlera neto) të njësisë gjeneruese;
- Arësyeja për padisponueshmërinë;
- Data e fillimit dhe mbarimit të ndryshimit të padisponueshmërisë (ditë,orë).

5.5.3 Prodhuesit e energjisë elektrike do të paraqesin të dhëna pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit jo më vonë se 50 minuta pas aprovimit të planit të ndërprerjeve.

5.5.4. Informacioni I pikës 5.5.2. do të publikohet një orë (H+1) pas aprovimit të planit të ndërprerjeve.

5.5.5. Në rastin e ndryshimit të të dhënave të paraqitura, prodhuesi do të riparaqesi të dhënat e sakta jo më vonë se një orë (H+1) pas ndryshimit të të dhënave të paraqitura.

5.6 PADISPONUESHMËRIA AKTUALE E NJËSIVE GJENERUESE

5.6.1. Operatori I Sistemit të Transmetimit do të publikojë të dhënat në lidhje me padisponueshmërinë aktuale të njësive gjeneruese në rast se padisponueshmëria është më e madhe ose e barabartë me 100 MW dhe me një kohëzgjatje jo më pak se një interval I llogaritur.

5.6.2 Prodhuesit do të paraqesin të dhëna pranë Operatorin të Sistemit të Transmetimit:

- Emrin e njësisë prodhuese;
- Emrin e njësisë gjeneruese;
- Vendndodhjen;
- Kapacitetin e instaluar (MW);
- Tipin e gjeneruesit;
- Kapaciteti në dispozicion (vlera neto) të njësisë gjeneruese;
- Arësyeja për padisponueshmërinë;
- Data e fillimit dhe mbarimit të ndryshimit të padisponueshmërisë (ditë,orë).

5.6.3. Prodhuesit e energjisë elektrike do të paraqesin të dhëna e pikës 5.6.2. pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit jo më vonë se 50 minuta pas ndryshimit të disponibilitetit.

5.6.4. Informacioni I pikës 5.6.2. do të publikohet një orë (H+1) pas ndryshimit të disponibilitetit.

5.6.5. Në rastin e ndryshimit të të dhënave të paraqitura, prodhuesi do të riparaqesi të dhënat e sakta jo më vonë se një orë (H+1) pas ndryshimit të të dhënave të paraqitura.

5.7. PADISPONUESHMËRIA E PLANIFIKUAR E NJËSIVE PRODHUESE

5.7.1 Operatori I Sistemit të Transmetimit do të publikojë të dhënat në lidhje me padisponueshmërië e planifikuar të njësive prodhuese në rast se padisponueshmëria e planifikuar është më e madhe ose e barabartë me 100 MW dhe me një kohëzgjatje jo më pak se një interval i llogaritur. Të dhënat do të publikohen për njësitë prodhuese me fuqi të instaluar më të madhe ose të barabartë me 200 MW.

Në rastin se këto të dhëna janë publikuar bashkë me të dhënat e pikës 5.5, atëherë Operatori I Sistemit të Transmetimit nuk do t'i publikojë këto të dhëna në mënyrë të ndarë.

5.7.2 Prodhuesit do të paraqesin të dhëna të padisponueshmërisë së prodhimit për një periudhë prej tre vitesh, sic vijon:

- Emrin e njësisë prodhuese;
- Vendndodhjen;
- Kapacitetin e instaluar (MW);
- Tipin e gjeneruesit;
- Kapaciteti në dispozicion (vlera neto) të njësisë prodhuese;
- Arësyeja për padisponueshmërinë;
- Data e fillimit dhe mbarimit të ndryshimit të padisponueshmërisë (ditë,orë).

5.5.3 Prodhuesit e energjisë elektrike do të paraqesin të dhëna pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit jo më vonë se 50 minuta pas aprovimit të planit të ndërprerjeve.

5.7.4. Informacioni I pikës 5.7.2. do të publikohet një orë (H+1) pas aprovimit të planit të ndërprerjeve.

5.5.5. Në rastin e ndryshimit të të dhënave të paraqitura, prodhuesi do të riparaqesi të dhënat e sakta jo më vonë se një orë (H+1) pas ndryshimit të të dhënave të paraqitura.

5.8 PADISPONUESHMËRIA FAKTIKE E NJËSIVE PRODHUESE

5.8.1. Operatori I Sistemit të Transmetimit do të publikojë të dhënat në lidhje me pamundësinë aktuale të njërive prodhuese në rast se padisponueshmëria është më e madhe ose e barabartë me 100 MW dhe me një kohëzgjatje jo më pak se një interval I llogaritur, me fuqi të instaluar më të madhe ose të barabartë me 200 MW.

5.8.2. Në rastin se këto të dhëna janë publikuar bashkë me të dhënat e pikës 5.6, atëherë Operatori I Sistemit të Transmetimit nuk do t'i publikojë këto të dhëna në mënyrë të ndarë.

5.8.3 Prodhuesit do të paraqesin të dhëna pranë Operatorin të Sistemit të Transmetimit:

- Emrin e njësisë prodhuese;
- Vendndodhjen;
- Kapacitetin e instaluar (MW);
- Tipin e gjeneruesit;
- Kapaciteti në dispozicion (vlera neto) të njësisë gjeneruese;
- Arësyeja për padisponueshmërisë;
- Data e fillimit dhe mbarimit të ndryshimit të padisponueshmërisë (ditë,orë).

5.8.4. Prodhuesit e energjisë elektrike do të paraqesin të dhënat jo më vonë se 50 minuta pas ndryshimit të disponibilitetit.

5.8.5.. Të dhënat e pikës 5.8.3. do të publikohen një orë (H+1) pas ndryshimit të disponibilitetit.

5.8.6. Në rastin e ndryshimit të të dhënave të paraqitura, prodhuesi do të riparaqesi të dhënat e sakta jo më vonë se një orë (H+1) pas ndryshimit të të dhënave të paraqitura.

5.9. GJENERIMI FAKTIK PËR NJËSI

5.9.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë gjenerimin aktual (vlera neto), për njësi gjeneruese për çdo interval të llogaritur në ditën (D). Të dhënat do të publikohen për njësitë gjeneruese me fuqi të instaluar më të madhe ose të barabartë me 100 MW.

5.9.2. Prodhuesit e energjisë elektrike do të paraqesin të dhënat pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sipas pikës 5.9.1. jo më vonë se 4 ditë (D+4) pas ditës (D) më të cilën lidhen të dhënat.

5.9.3. Të dhënat do të publikohen pesë ditë (D+5) pas ditës (D) me të cilën lidhen të dhënat.

5.9.4. Riparaqitja e të dhënave do të jetë e mundur në rast se duhet të korigjohen vlera të cilat janë paraqitur më përpara.

5.10. NJËSITË GJENERUESE TË MBLEDHURA SIPAS TIPIT

5.10.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë gjenerimin aktual të mbledhur (vlera neto) për njësi gjeneruese (vlera mesatare e mbledhur) për çdo interval të llogaritur në ditën (D).

5.10.2. Prodhuesit e energjisë elektrike do të paraqesin të dhënat pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit për njësitë gjeneruese të lidhura në sistemin e transmetimit jo më vonë se 50 minuta pas çdo intervali të llogaritur.

5.10.3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose Operatori i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes do të paraqesi të dhënat pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të dhënat të përmbledhura sipas njësive gjeneruese në sistemin e shpërndarjes ose në sistemin e mbyllur të shpërndarjes, maksimalisht 50 minuta pas çdo intervali të llogaritur.

5.10.4. Në rast se të dhënat e matura nuk janë të disponueshme, mund të paraqiten vlerat e vlerësuar.

5.10.5 Të dhënat e pikës 5.10.1. mbidhen sipas tipit të gjenerimit dhe do të publikohen jo më vonë se një orë (H+1) pas çdo intervali të llogaritur.

5.10.6. Riparaqitja e të dhënave do të jetë e mundur në rast se duhet të korigjohen vlera të cilat janë paraqitur më përpara.

5.11 GJENERIMI FAKTIK PËR EOLIKËT DHE FOTOVOLTAIKËT

5.11.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë gjenerimin aktual ose të vlerësuar (vlera neto) për energjinë diellore dhe totalin aktual ose të vlerësuar të energjisë elektrike (vlerë neto) për energjinë nga era për çdo interval të llogaritur në ditën (D).

5.11.2. Prodhuesit e energjisë elektrike do të paraqesin të dhëna pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit për njëstë prodhuese të lidhura në sistemin e transmetimit jo më vonë se 50 minuta pas çdo intervali të llogaritur.

5.11.3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose Operatori i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes do të paraqesë te Operatori i Sistemit të Transmetimit të dhënat e grumbulluara në Sistemin e Shpërndarjes ose në Sistemin e Mbyllur të Shpërndarjes, maksimumi 50 minuta pas çdo intervali llogaritës.

5.11.4. Në rast se vlerat e matura nuk janë në dispozicion, mund të paraqiten vlerat e parashikuara.

5.11.5. Informacioni duhet të publikohet jo më vonë se një orë (H + 1) pas çdo intervali llogaritës.

5.11.6. Ridërgimi i të dhënave do të jetë i mundur në rast të korigjimit të vlerave të paraqitura më parë. Në rast të paraqitjes së vlerave paraprake, Prodhuesi dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose Operatori i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes duhet të paraqesë vlerat përfundimtare.

6. TË DHËNAT THEMELORE TË TREGUT PËR BALANCIMIN

6.1. RREGULLAT E BALANCIMIT

6.1.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të mundësojë aplikimin e dispozitave të Rregullave të Balancimit dhe do ti përditësojë ato në mënyrë të rregullt.

6.2. SASIA E REZERVAVE BALANCUESE TË KONTRAKTUAR

6.2.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë sasinë e rezervave balancuese (MW) për llojin e rezervës (rezerva primare, sekondare, terciare).

6.2.2. Të dhënat të cilat do të publikohen për secilin lloj të rezervës:

- burimi i rezervës (gjenerim ose ngarkesë);
- drejtimi i rregullimit (rregullimi nga lart ose rregullimi nga poshtë);
- sasia e rezervës balancuese (MW);
- periudha kohore për të cilën rezervat janë kontraktuar (orë, ditë, javë, muaj, vit).

6.2.3. Informacioni do të publikohet një orë ($h + 1$) pas procesit të prokurimit të rezervës.

6.3. ÇMIMET E KAPACITETIT REZERVË TË REZERVAVE BALANCUESE

6.3.1. Operatori i Sistemit të Transmisionit do të publikojë çmimet e kapacitetit rezervë të rezervave balancuese (EUR/MW) për llojin e rezervave (rezerva primare, sekondare dhe terciare).

6.3.2. Të dhënat të cilat do të publikohen :

- lloji i rezervës (rezerva primare, sekondare dhe terciare);
- burimi i rezervës (gjenerim ose ngarkesë);
- drejtimi i rregullimit (rregullimi nga lart ose rregullimi nga poshtë);
- çmimi i rezervës balancuese të prokuruar (EUR/MW);
- periudha kohore për të cilën rezervat janë kontraktuar (orë, ditë, javë, muaj, vit).

6.3.3. Të dhënat do të publikohen një orë (H_2+1) pas procesit të prokurimit të rezervës.

6.4. OFERTAT TOTALE TË PRANUARA

6.4.1. Operatori i Sistemit të Transmisionit do të publikojë rezervën balancuese totale në dispozicion (MW) për llojin e reserves, për çdo interval llogaritje në një dite (D).

6.4.2. Rezerva totale balancuese në dispozicion përbëhet nga rezerva balancuese në dispozicion nga subjektet e balancimit dhe rezerva balancuese e kontraktuar, e mbetur pas planeve ditor të punës të pranuar për çdo interval llogaritje.

6.4.3. Të dhënat të cilat do të publikohen :

- rezerva totale balancuese në dispozicion në intervalin llogaritës (MW);
- lloji i rezervës (rezerva primare, sekondare dhe terciare);
- burimi i rezervës (gjenerim ose ngarkesë);
- drejtimi i rregullimit (rregullimi nga lart ose rregullimi nga poshtë).

6.4.4 Të dhënat do të publikohen jo më vonë se 30 minuta pas çdo intervali llogaritje.

6.5 VËLLIMET E REZERVAVE TË AKTIVIZUARA TË BALANCIMIT

6.5.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë vëllimet e rezervave të aktivizuara të balancimit në intervalin llogaritës (MWh), të ndara sipas llojit të rezervës së aktivizuar

6.5.2. Do të publikohet informacioni i mëposhtëm :

- energjia balancuese e aktivizuar (MWh) në intervalin llogaritës ;
- lloji i energjisë balancuese të aktivizuar (rezerva primare, sekondare dhe terciare);
- burimi i rezervës së energjisë balancuese të aktivizuar (gjenerim ose ngarkesë);
- drejtimi i rregullimit (rregullimi nga lart ose rregullimi nga poshtë).

6.5.3 Të dhënat do të publikohen jo më vonë se 30 minuta pas çdo intervali llogaritje.

6.6 ÇMIMET E REZERVAVE TË AKTIVIZUARA TË BALANCIMIT

6.6.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë çmimet e rezervave të aktivizuar të balancimit në intervalin llogaritës (EUR / MWh), të ndara sipas llojit të rezervës.

6.6.2. Në rast se Operatori i Sistemit të Transmetimit shet/blen energji balancuese me qëllim balancimin e sistemit sipas metodës së çmimit të ofruar, çmimi i ponderuar i të gjitha ofertave të aktivizuara në periudhën llogaritëse përkatëse do të publikohet.

6.6.3. Në rast se Operatori i Sistemit të Transmetimit shet/blen energji balancuese me qëllim balancimin e sistemit sipas metodës së çmimit marginal, çmimi marginal i të gjitha ofertave të aktivizuara në periudhën llogaritëse përkatëse do të publikohet.

6.6.4. Do të publikohet informacioni i mëposhtëm :

- çmimet e energjisë balancuese të aktivizuar në intervalin llogaritës (EUR / MWh);
- lloji i rezervës (rezervat primare, sekondare dhe terciare);
- burimi i rezervës (gjenerim ose ngarkesë);
- drejtimi i rregullimit (rregullimi nga lart ose rregullimi nga poshtë).

6.6.5 Të dhënat do të publikohen jo më vonë se 1 orë (H+1) pas çdo intervali llogaritje.

6.7 ÇMIMI I DISBALANCAVE

6.7.1 Operatori I Sistemit të Transmetimit publikon çmimin e disbalancave (EUR/MWh) për çdo interval llogaritje në një ditë (D).

6.7.2 Të dhënat do të publikohen ditën pasardhëse (D+1) për vlerat që kanë të bëjnë me ditën (D).

6.8 VËLLIMI TOTAL I DISBALANCAVE

6.8.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë vëllimin total të disbalancave të zones së kontrollit për çdo interval llogaritje në një ditë (D).

6.8.2. Të dhënat do të publikohen jo më vonë se 30 minuta pas çdo intervali llogaritje.

6.9 BALANCA MUJORE FINANCIARE

6.9.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë të dhëna mbi shpenzimet dhe të ardhurat totale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (EUR) të bazuara në:

- a) shumën e llogaritur të rezervës balancuese të kontraktuar për periudhën llogaritëse ;
- b) energjia e aktivizuar balancuese llogaritëse nga subjektet balancuese për periudhën llogaritëse ;
- c) detyrimet e llogaritura për të gjitha grupet balancuese për periudhën llogaritëse.

6.9.2. Të dhënat do të publikohen në ditën e fundit kalendarike të muajit M + 3 për muajin M.

6.9.3. Në rast të korigjimit të bilancit financiar, Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë të dhënat e korigjuara nga neni 6.9.1.

6.10.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit publikon fuqinë agregate (MW) për çdo interval llogaritje, nga oferta për:

- a) aktivizimi i rregullimit nga lart nga zonat e kontrollit fqinje;
- b) aktivizimi i poshtë-rregullimit nga zonat e kontrollit fqinje.

6.10.2. Në rast se në aktivizimin e ofertave një listë e përbashkët e aktivizimit të rezervës balancuese është përdorur në rregullimet terciare, i përbërë edhe nga subjektet balancuese nga zonat e kontrollit fqinje dhe që janë publikuar në përputhje me nenin 6.4, Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk do të publikojë të dhëna të tilla veç e veç.

6.10.3. Të dhënat do të publikohen jo më vonë se një orë (H + 1) pas çdo intervali llogaritje.

6.11. ÇMIMET PËR ZONËN E BALANCIMIT NDËR-ZONALE PËR KËRKESAT DHE OFERTAT

6.11.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë çmimet minimale dhe maksimale (EUR / MW) për secilin interval llogaritje nga oferta për:

- a) aktivizimin e rregullimit nga lart nga zonat e kontrollit fqinje;
- b) aktivizimin e poshtë-rregullimit nga zonat e kontrollit fqinje.

6.11.2. Në rast se në aktivizimin e ofertave një listë e përbashkët e aktivizimit të rezervës balancuese është përdorur në rregullimet terciare, i përbërë edhe nga subjektet balancuese nga zonat e kontrollit fqinje dhe që janë publikuar në përputhje me nenin 6.6, Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk do të publikojë të dhëna të tilla veç e veç.

6.11.3. Të dhënat do të publikohen jo më vonë se një orë (H + 1) pas çdo intervali llogaritje.

6.12 VËLLIMET E ENERGJISË BALANCUESE NDËR-ZONALE TË AKTIVIZUAR

6.12.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë energjinë balancuese të aktivizuar nga zonat e kontrollit fqinje në çdo interval llogaritës për shkak të:

- a) aktivizimit të lart-rregullimit ;
- b) aktivizimit të poshtë-rregullimit.

6.12.2. Të dhënat do të publikohen jo më vonë se një orë (H + 1) pas çdo intervali llogaritje.

7.1.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë të dhënat e përcaktuara në nenet 5.10 dhe 5.12 të këtyre Rregullave, duke filluar nga data 2017.

7.1.2. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë të dhënat e përcaktuara në nenet 4.14, 4.16, 5.6, 5.8, 6.4, 6.5, 6.6, 6.10, 6.11 dhe 6.12 të këtyre Rregullave, duke filluar nga data 1 Janar 2018.

7.1.3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të dorëzojë të dhënat e përcaktuara nga neni 3.1 i këtyre Rregullave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, duke filluar nga data 1 Janar 2018.

7.1.4. Prodhuesi do të dorëzojë të dhënat e përcaktuara nga neni 5.9 i këtyre Rregullave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, duke filluar nga data 1 Janar 2018.

7.1.5. Të dhënat në lidhje me parashikimin dhe prodhimin aktual nga energjia diellore dhe ajo e erës nga nenet 5.4. dhe 5.1 të këtyre Rregullave, do të publikohet atëherë kur pjesa e energjisë elektrike të prodhuar nga këto burime të rinovueshme të tejkalojë 5% të totalit të prodhimit vjetor të energjisë elektrike. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të informojë në kohë prodhuesit, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatorët e Sistemeve të mbyllura të Shpërndarjes, në lidhje me plotësimin e kushtit të mësipërm.

7.1.6. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga ana e Bordit të ERE-s.